# DËSHMI ARKIVI

**A-464468**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Studimi: Vetmia dhe izolimi social merr deri në gjashtë vjet jetë pa sëmundje |
| ADRESA | `https://www.koha.net/lifestyle/studimi-vetmia-dhe-izolimi-social-merr-deri-ne-gjashte-vjet-jete-pa-semundje` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 00:55:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 13:15:03 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `fb829756969ce2b5f8084cc302cd7b09fb3712747fc3d895b8b1a43def72e9f7` |
| TEKSTI | `c9d8e6b53f85b55dcbd882e7338879ddc25fc6ec99dd2e5bbd8d696c3245c198` |
| PAMJA | `8ab7bc0d216aa2e2a70b0dbddbf59563704daa545eb6b5cbbdd1edb8338d8cd6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5ebcfffe442322e8b8b9ae48aef83235037bf617b540bf1606d0df211ede84d5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dda7d23b558402c926cd6fed567bb6eba8126329f8a189914308aeb661b57cd2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5ebcfffe442322e8b8b9ae48aef83235037bf617b540bf1606d0df211ede84d5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

LIFESTYLE

# Studimi: Vetmia dhe izolimi social merr deri në gjashtë vjet jetë pa sëmundje



Foto ilustrim

23 shtator 2026 15:15

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Vetmia dhe izolimi social nuk ndikojnë vetëm në mirëqenien emocionale. Një studim i ri sugjeron se të dyja lidhen me më pak vite jetë pa sëmundje kronike, ndërsa ndikimi ndryshon edhe mes grave dhe burrave.

Këta dy faktorë mund të shkurtojnë ndjeshëm vitet që një person kalon pa sëmundje, duke ndikuar si në shëndetin fizik, ashtu edhe në atë mendor, raportoi Euronews.

Ky është përfundimi i një studimi të publikuar në revistën shkencore "Nature Communications", i cili analizoi të dhënat e më shumë se 270 mijë personave të moshës 40 deri në 69 vjeç.

Sipas studiuesve, në përgjithësi, vetmia dhe izolimi social lidhen me humbjen e rreth gjashtë viteve jetë pa sëmundje.

"Mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në jetëgjatësinë pa sëmundje", tha autori kryesor i studimit, Lu Qi, profesor në Universitetin Tulane.

Edhe



Lifestyle • 15 sht 2026
E doni punën nga shtëpia? Mund të kushtojë me shëndetin mendor

Studiuesit bëjnë dallim mes dy koncepteve.

Izolimi social lidhet me kontaktet e kufizuara dhe pjesëmarrjen e ulët në marrëdhënie apo aktivitete me njerëz të tjerë.

Vetmia, në anën tjetër, është një përjetim subjektiv. Një person mund të jetë i rrethuar nga njerëz dhe sërish të ndihet i shkëputur ose i vetmuar.

Megjithëse nuk janë e njëjta gjë, studimi i lidh të dyja me një numër më të vogël vitesh të jetuara pa sëmundje.

Ndikimi është i fortë në lidhje me shëndetin mendor, përfshirë

Arbëri.
Vuçiqi në Asamblenë e OKB-së falënderon shtetet që s'e kanë njohur Kosovën

Arbëri.
Vela e cilëson gjysmak vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Kulturë.
"Valle tradicionale të Opojës" në hap të ruajtjes së thesareve popullore

Showbiz.
Harvey Weinstein dënohet me 15 vjet burgim për sulm seksual

Basketboll.
Peja mposhtet thellë, kualifikimi thuajse i pamundur

Botë.
Zelensky në OKB: Putini është "pacienti zero", prej të cilit lufta vazhdon të përhapet

depresionin dhe ankthin, sesa me sëmundje fizike.

Në analizë u morën parasysh edhe sëmundje si diabeti i tipit 2, sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet kronike të frymëmarrjes dhe kanceri.


Edhe



Lifestyle • 9 sht 2026

Studimi: Duhanpirja mund t'ju bëjë më të vetmuar


Studimi tregon gjithashtu dallime të rëndësishme mes gjinive.

Te gratë, vetmia dhe izolimi social u shoqëruan me rreth 2.4 vjet më pak jetë pa probleme të rëndësishme fizike dhe 3.7 vjet më pak jetë pa çrregullime të shëndetit mendor.

Te burrat, humbja e viteve pa sëmundje fizike ishte rreth 1.7 vjet, ndërsa humbja e viteve pa çrregullime mendore arrinte në 5.8 vjet.

Sipas studiuesve, këto dallime mund të lidhen me mënyrën se si gratë dhe burrat krijojnë marrëdhënie dhe marrin mbështetje.

Gratë mund të mbështeten më shumë te lidhjet emocionale, duke bërë që vetmia të ketë një lidhje më të fortë me shëndetin e tyre mendor. Burrat, ndërkohë, mund të mbështeten më shumë te prania fizike dhe ndërveprimet e shpeshta sociale, çka mund ta bëjë izolimin social më të rëndësishëm për mirëqenien e tyre psikologjike.


Edhe



Lifestyle • 12 dhj 2025

Faktori kritik që parashikon jetëgjatësinë më mirë se ushqimi apo aktiviteti fizik


Studimi solli edhe një element pozitiv.

Mbajtja e një stili të shëndetshëm jetese duket se mund të zbusë një pjesë të ndikimit negativ të izolimit social. Megjithatë, sipas gjetjeve, një mënyrë jetese e shëndetshme nuk duket se e kompenson plotësisht ndikimin e vetmisë.

#VETMIA #IZOLIMI SOCIAL #LIFESTYLE


## Artikuj të ngjashëm



Lifestyle • 18 gus 2026

Pas COVID-19, gati 1 në 10 të rinj thotë se nuk ka asnjë kontakt ballë për ballë gjatë ditës



Lifestyle • 6 gus 2026

Tri zakone të shëndetshme në moshën e mesme mund ta vonojnë demencën deri në 13 vjet



KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.



Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies



Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!



+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë



AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK


Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.